



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E KULTURËS, SPORTIT DHE TURIZMIT

PROJEKT-VENDIM

NR 89 .DATE 21.06.2024

PËR DHËNIEN E TITULLIT "QYTETAR NDERI"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, përkatësisht neni 9 pika 1.7 gërma a), neni 54 pika m); te Ligjit nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë" neni 8, neni 9 pika 1, neni 11 pika 2, neni 13; VKM-së nr. 861, date 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave te hollesishme per funksionimin e komisioneve keshillimore për dhënie e medalieve dhe titujve vendore te nderit ne Republiken e Shqiperise";

Ju paraqesim për diskutim e miratim,

1. Propozimin për Dhënie e Titullit "Qytetar Nderi" të Bashkisë Roskovec, si më poshtë:
 - a) **Thanas Goga**, njihet për fushën e inxhinerisë në minierën e bakrit si dhe Kryetar i organizimit të punës dhe pagave në Drejtorinë e Përgjithshme të Industrisë së Bakrit.
 - b) **Zylyftar Xhaxho**, njihet për kontributin e dhënë prej 32 vitesh ne Ndërmarrjen Sizmike, marrëdhënie e ngushta që krijoi me miq dhe kolegë.
 - c) **Kozma Apostoli**, është dalluar si nxënës shumë i mire në Teknikumin Bujqësor, në Filialin e Universitetit të Tiranës në Fier, për degën Matematikë dhe Fizikë dhe vazhdoi studimet natën për katër vjet. Njihet për përkushtim ndaj cdo detyre të dhënë të kryera me devotshmëri si dhe ndershmëri.
 - d) **Bashkim Çepele**, është dalluar falë aftësive të tij të punës së përkushtuar dhe respektit të fituar me dinjitet ku ka qenë në poste drejtuese, brigadier, teknik sektori ,Përgjegjës i Sektorit të Investimeve (Ndërtimit) në NB Roskovec.Njihet si një nga drejtuesit e ndërtuesve Roskovecare që dhanë kontributin për Rindërtimin e zonave të prekura nga tërmeti i 15 Prillit 1978 në Shkodër.
 - e) **Aleksandër Jorgaqi**, rrjedh nga një familje juristi patriot (Vasil Jorgaqi) emrin e të cilit e mban një rrugë në lagjen Kastriot Fier. Është dekoruar me Medalje Pune dhe

Urdhër Pune dhe për aftësi dhe punë të mire është dërguar në Hollandë me shërbim. Njihet si një nga personat që arritën të bëjnë Fermën e tyre Shkollë të Republikës për prodhimin e mishit.

2. Pas miratimit të këtij projekt-vendimi në Këshillin e Bashkisë ngarkohet Komisioni Këshillimor për dhënien e titujve vendor të nderit, për kryerjen e procedurave përkatëse.

Konceptoi: E.Toska

Konfirmoi: M.Goga

Për Drejtorinë Juridike: V.Zeqo

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3 (tre)

KRYETAR
Majlinda Buri

